



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**SHPALLJE PËR LËVIZJE PARALELE,
NGRITJE NË DETYRË,
NË KATEGORINË E ULËT DREJTUESE.**

Në zbatim të nenit 26 të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Kreu V – “Lëvizja paralele dhe ngritja në detyrë”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.242, datë 18.03.2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, njëjësia përgjegjëse pranë Komisionit të Prokurimit Publik shpall procedurën e lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë për pozicionin:

***Përgjegjës i Sektorit të Teknologjisë së Informacionit dhe Publikimit në Drejtorinë e Monitorimit, Shërbimeve Mbështetëse dhe Financës, në Komisionin e Prokurimit Publik –
Kategoria e pagës: III-1 (1 (një) vend vakant)***

Pozicioni më sipër, i ofrohen fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se një pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

Afati për dorëzimin e Dokumenteve:	Shih procedurat përkatëse
Deri në 11.09.2025	Lëvizja paralele
Deri në 16.09.2025	Ngritje në detyrë

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin më sipër është:

1. Të menaxhojë dhe sigurojë mirëmbajtjen e rrjetit të pajisjeve kompjuterike të institucionit;

2. Të ofrojë mbështetje teknike për printerat dhe PC-të e institucionit si dhe sistemin thin client
3. Të ofrojë zgjidhjen e problematikave të pajsjeve të teknologjisë së informacionit;
4. Siguron që të gjithë sistemet kompjuterike dhe rrjeti i internetit të përdoren vetëm për qëllime pune, duke u bazuar tërësisht në përcaktimet e Rregullores së Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë të Informacionit (AKSHI), datë 03.09.2018 “Mbi përdorimin e postës elektronike në Administratën Publike”, si edhe Manualit mbi përdorimin e shërbimit të internetit dhe postës elektronike, të miratuar nga Kryetari i KPP-së;
5. Të sigurojë ruajtjen e konfidencialitetit lidhur me informacionin që qarkullon, ruhet dhe aksesohet;
6. Të sigurojë vazhdimësinë e shërbimit të e - mail dhe vazhdimësinë e shërbimit të internet-it;
7. Mbikqyr veprimtarinë administrative, udhëzon, këshillon dhe ndjek nga afër zbatimin e detyrave të stafit nën varësi.
8. Është përgjegjës për sigurimin e mbështetjes së rrjetit kompjuterik, për trajtimin e të dhënave/informacioneve, si dhe për probleme të veçanta.

I-Lëvizja paralele

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a) të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda të njëjtës kategori për të cilën aplikon (kategoria III-1);
- b) të mos ketë masë disiplinore në fuqi (**të vërtetuar me një dokument nga institucioni**);
- c) të ketë të paktën vlerësimin e fundit pozitiv “**mirë**” apo “**shumë mirë**”.
- d) Të plotësojë kriteret e veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurrim;

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

Arsimimi:

- Të zotërojë diplomë të nivelit "**Master Shkencor**", në **Shkencat Informatike / Kompjuterike / Inxhinieri Elektronike / Informatikë-Elektronike /Informatikë-Ekonomike/Informatikë-Matematikë/Teknologji Informacioni/Inxhinieri telekomunikacioni.**
Diploma Bachelor të jetë e së njëjtës fushe.

Përvoja:

Të ketë 3 (tre) vite eksperiencë pune në profesion.

Tjetër:

- a- të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup;
- b- aftësi për të planifikuar, rishikuar dhe drejtuar punën e stafit nën varësi; aftësi shumë të mira komunikimi, prezantimi;
- c- njohje e mirë dhe përdorim i lirshëm i kompjuterit dhe programeve bazë.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë zyrës së protokollit të Komisionit të Prokurimit Publik, dokumentet origjinalë (ose të njehësuar me origjinalin) si më poshtë:

- 1) Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në lidhjen <http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>; (origjinal);
- 2) Kërkesë për të konkurruar në pozicionin e shpallur, duke specifikuar llojin e procedurës së rekrutimit për të cilin po aplikohet; (origjinal);
- 3) Dokumentin origjinal ose fotokopje të njehsuar me origjinalin të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë, të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
- 4) Listë notash, të njehsuar me origjinalin
- 5) Fotokopje të njehsuar me origjinalin të librezës së punës (të gjithë faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- 6) Fotokopje të njehsuar me origjinalin të letërnjoftimit (ID)) ose pasaportës;
- 7) Vërtetim të gjendjes shëndetësore; (Të jetë e periudhës që po aplikoni)
- 8) Vërtetim të gjendjes gjyqësore (Të jetë e periudhës që po aplikoni)
- 9) Letër motivimi për aplikim në vendin vakant; (origjinal);
- 10) Dokumentin origjinal ose fotokopje të noterizuar të çdo dokumentacioni tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- 11) Dokumentin origjinal ose fotokopje të njehsuar me origjinalin të aktit të emërimit si nëpunës civil;
- 12) Dokumentin origjinal ose fotokopje të njehsuar me origjinalin të vërtetimit ku specifikohet kategoria e pagës në pozicionin aktual që ushtron kandidati;

13) Dokumentin origjinal ose fotokopje të njehsuar me origjinalin të vërtetimit nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi, i cili duhet të jetë i muajit të aplikimit;

14) Dokumentin origjinal ose fotokopje të noterizuar të vlerësimit të fundit nga eprori direkt; (vlerësim të 6-mujorit të fundit dhe vlerësim të përgjithshëm (deri në momentin e aplikimit);

15) të dorëzojnë dokumentet e parashikuara në pikën 1.2.

Mosparaqitja e plotë e dokumenteve të sipërcituara, sjell **skualifikimin** e kandidatit.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 11.09.2025, në Zyrën e Protokollit të Komisionit të Prokurimit Publik, Blv “Dëshmorët e Kombit”, Pallati i Kongreseve, Kati i parë, Tiranë.

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Duke filluar nga data **15.09.2025**, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore (Njësia Përgjegjëse) pranë Komisionit të Prokurimit Publik, do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të KPP-së, dhe në standat e informimit të publikut, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista. Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga Njësia Përgjegjëse e institucionit, nëpërmjet adresës së e-mailit, për shkaqet e moskualifikimit.

Ankesat nga kandidatët paraqiten në Njësinë Përgjegjëse brenda 3 (tre) ditëve kalendarike nga shpallja e listës dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Ligjin nr. 162/2020, datë 23.11.2020 “Për Prokurimin Publik”;
- Ligjin nr. 10325, datë 23.09.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”;
- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.
- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.”
- Vendimin e KPP-së nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.
- Ligjin nr.9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”.

- Ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar
- Ligjin Nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë";
- Ligji nr. 9131, datë 08/09/2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”
- Ligjin nr, 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera lidhur me to’;
- Ligjin nr. 119/2014, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”
- Ligjin Nr.9180, datë 5.2.2004 “Për statistikën Zyrtare” i ndryshuar;
- Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar
- Ligji nr. 9880, datë 25/02/2008 “Për nënshkrimin elektronik”, ndryshuar me aktin normative nr.8 datë 30/09/2009, miratuar me ligjin nr. 10 178, datë 29/10/2009, ndryshuar me ligjin nr. 122/2016.
- Ligji nr. 9918, datë 19/05/2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar me ligjin nr. 102/2012, datë 20.12.2018; nr. 92/2019, datë 18/12/2019.
- Vendimi nr. 252, datë 29/04/2022 “Për procedurat e ofrimit të shërbimeve On-Line nga Institucionet Shërbimofruese dhe për metodologjinë e monitorimit të kontrollit të kontrollit të veprimtarisë veprimtarisë administrative të ofrimit të tyre”.

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen nga Komiteti i Pranimi për Levizje Paralele, i ngritur në KPP, nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar dhe intervistës së strukturuar me gojë. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidateve është 100 pikë, të cilat ndahen përkatësisht:

- **Kandidatët do të vlerësohen për përvojën**, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe çertifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i çertifikimit nuk është kryer. Totali i pikëve për këtë vlerësim është **40 pikë**.
- **Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**
 - a- njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
 - b- eksperiencën e tyre të mëparshme;
 - c- motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është **60 pikë**.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurave të lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”, të Departamentit të Administratës Publike www.dap.gov.al në lidhjen <http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>.

Komisioni në përfundim të vlerësimit, njofton individualisht kandidatët që kanë konkuruar për rezultatin e tyre. Kandidatët kanë të drejtë të bëjnë ankim me shkrim në Komisionin e Brendshëm

për Lëvizjen Paralele për rezultatin e vlerësimit, brenda 3 (tre) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual mbi rezultatin. Ankuesi merr përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike, nga data e përfundimit të afatit të ankimit. Komisioni brenda 24 (njëzetë e katër) orëve pas përfundimit të procedurave të ankimit, për zgjedh kandidatin, i cili renditet i pari ndër kandidatët që kanë marrë të paktën 70 pikë.

1.6

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia Përgjegjëse e Komisionit të Prokurimit Publik do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të KPP-së. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.

2- NGRITJE NË DETYRË NË KATEGORINË E ULËT DREJTUESE

Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende është pozicion vakant, ai është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

Këtë informacion do ta merrni në faqen e KPP-së, pas datës 15.09.2025.

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë vetëm nëpunësit civilë të një kategorie paraardhëse (vetëm një kategori më e ulët), të punësuar në të njëjtin apo në një institucion tjetër të shërbimit civil, që plotësojnë kushtet për ngritjen në detyrë dhe kërkesat e veçanta për vendin e lirë.

2.1

KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E NGRITJES NË DETYRË

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për procedurën e ngritjes në detyrë si janë:

- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, në kategorinë IV-1;
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni);
- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit pozitiv “mirë” apo “shumë mirë”;

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

Arsimimi:

Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor", në Shkencat Informatike / Kompjuterike / Inxhinieri Elektronike / Informatikë-Elektronike / Informatikë-Ekonomike/Informatikë-Matematikë/Teknologji Informacioni/Inxhinieri telekomunikacioni. Diploma Bachelor të jetë e së njëjtës fushe.

Përvoja:

Të ketë 3 (tre) vite eksperiencë pune në profesion.

Tjetër:

- d- të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup;
- e- aftësi për të planifikuar, rishikuar dhe drejtuar punën e stafit nën varësi; aftësi shumë të mira komunikimi, prezantimi;
- f- njohje e mirë dhe përdorim i lirshëm i kompjuterit dhe programeve bazë.

2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë zyrës së protokollit të Komisionit të Prokurimit Publik, **dokumentet origjinalë (ose të njehësuar me origjinalin)** si më poshtë:

- 1)
- 1) Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në lidhjen <http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>; (origjinal);
- 2) Kërkesë për të konkurruar në pozicionin e shpallur, duke specifikuar llojin e procedurës së rekrutimit për të cilin po aplikohet; (origjinal);
- 3) Dokumentin origjinal ose fotokopje të njehsuar e origjinalin të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë, të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
- 4) Listë notash, fotokopje të njehsuar me origjinalin;
- 5) Fotokopje të njehsuar me origjinalin të librezës së punës (të gjithë faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë;
- 6) Fotokopje të njehsuar me origjinalin të letërnjoftimit (ID) ose pasaportës;
- 7) Vërtetim i gjëndjes gjyqësore, (e periudhës që aplikon);
- 8) Vërtetim të gjëndjes shëndetësore, (e periudhës që aplikon);
- 9) Letër motivimi për aplikim në vendin vakant; (origjinal)
- 10) Dokumentin origjinal ose fotokopje të njehsuar me origjinalin të çdo dokumentacioni tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- 11) të dorëzojnë dokumentet e parashikuara në pikën 2.2.

Mosparaqitja e plotë e dokumenteve të sipërcituara, sjell **skualifikimin** e kandidatit.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 16.09.2025, në Zyrën e Protokollit të Komisionit të Prokurimit Publik, Blv “Dëshmorët e Kombit”, Pallati i Kongreseve, Kati i parë, Tiranë.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e ngritjes në detyrë, do të informohen për fazat e mëtejshme të kësaj procedurë:

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak;
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;
- mënyrën e vlerësimit të kandidatëve.

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e KPP-së duke filluar nga data: 18.09.2025.

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Prej datës **18.09.2025**, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore (Njësia Përgjegjëse) pranë Komisionit të Prokurimit Publik, do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të KPP-së, dhe në stendat e informimit të publikut, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e ngritjes në detyrë dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista. Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e ngritjes në detyrë dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga Njësia Përgjegjëse e institucionit, nëpërmjet adresës së e-mailit, për shkaqet e moskualifikimit.

Ankesat nga kandidatët paraqiten në Njësinë Përgjegjëse brenda (5 (pesë) ditëve kalendarike dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Ligjin nr. 162/2020, datë 23.11.2020 “Për Prokurimin Publik”;
- Ligjin nr. 10325, datë 23.09.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”;
- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.
- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.”
- Vendimin e KPP-së nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.
- Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”.
- Ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar
- Ligjin Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji nr. 9131, datë 08/09/2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”
- Ligjin nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera lidhur me to”;

- Ligjin nr. 119/2014, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”
- Ligjin Nr.9180, datë 5.2.2004 “Për statistikat Zyrtare” i ndryshuar;
- Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e tw dhënave personale”, i ndryshuar
- Ligji nr. 9880, datë 25/02/2008 “Për nënshkrimin elektronik”, ndryshuar me aktin normative nr.8 datë 30/09/2009, miratuar me ligjin nr. 10 178, datë 29/10/2009, ndryshuar me ligjin nr. 122/2016.
- Ligji nr. 9918, datë 19/05/2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar me ligjin nr. 102/2012, datë 20.12.2018; nr. 92/2019, datë 18/12/2019.
- Vendimi nr. 252, datë 29/04/2022 “Për procedurat e ofrimit të shërbimeve On-Line nga Institucionet Shërbimofruese dhe për metodologjinë e monitorimit të kontrollit të veprimtarisë veprimtarisë administrative të ofrimit të tyre”.

2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatet do të vlerësohen, për dokumentacionet e dorëzuara, vlerësimit me shkrim dhe intervistës së strukturuar me gojë. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidateve është 100 pikë.

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- vlerësimin me shkrim, deri në 40 pikë;
- b- intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 40 pikë;
- c- dokumentacioni i dorëzuar, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, jetëshkrimit të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 20 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike www.dap.gov.al në lidhjen <http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>.

2.6

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore (Njësia Përgjegjëse) pranë Komisionit të Prokurimit Publik, do të shpallë kandidatët në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të KPP-së, si dhe në stendat e informimit të publikut. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për rezultatet (*nëpërmjet adresës së e-mail*).

Kandidatët fitues janë ata që renditen të parët nga kandidatët që kanë marrë të paktën 70 pikë (70% të pikëve). Njësia Përgjegjëse njofton individualisht kandidatët që kanë konkurruar për rezultatin e tyre brenda 24 (njëzetkatër) orëve nga dita që komiteti i njofton vendimin e tij. Kandidati ka të

drejtë të bëjë ankim me shkrim edhe në (KPND) për rezultatin e pikëve brenda 3 (tre) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual për rezultatin e vlerësimit. Ankuesi merr përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data përfundimit të afatit të ankimit.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia Përgjegjëse pranë Komisionit të Prokurimit Publik, do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të KPP-së . Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për rezultatet *(nëpërmjet adresës së e-mail)*.

2.7

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia Përgjegjëse pranë Komisionit të Prokurimit Publik, do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, dhe në faqen zyrtare të KPP-së.

Të gjithë kandidatët pjesëmarrës që aplikojnë në këtë procedurë, do të marrin informacion për fazat e mëtejshme të kësaj procedure;

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak;
- për datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi.

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e KPP-së duke filluar nga data **18.09.2025** e në vijim.